



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1548 prot.

Shkodër, më 23.04 2026

V E N D I M

Nr. 128, datë 23 . 04 .2026

"Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për ciklin e tretë të studimeve Doktoratë "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", për vitin akademik 2025-2026"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 72, 74 dhe 76; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa o, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim propozimin e Fakultetit Ekonomik, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2026

Vendosi:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit për ciklin e tretë të studimeve Doktoratë "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", për vitin akademik 2025-2026 (materiali bashkëngjitur).
2. Ky vendim t'i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Tonin BAJRAJ

KRITERET E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026

CIKLI I TRETË, “DOKTORATË”

KRITERET E PRANIMIT NE UNIVERSITETE 2025 - 2026		
Cikli i tretë i Studimeve Doktoratë		
IAL	Fakulteti	Programi i studimit
		Kriteret
		<p>Të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojë të paktën njëten nga diplomat “Master i Shkencave”, “Master i Arteve”, “Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë”, “Diplomë e Nivelit të Dytë”, “Diplomë Master Ekzekutiv”, “Diplomë lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatur, së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës”, apo diplomë nga një program studimi të barasvlefshëm të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga Ministria përgjegjëse e Arsimit në Shqipëri;</p> <p>-Të ketë rezultate të larta të studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë;</p> <p>-Të ketë të mbrojtur me test ndërkombëtar një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, fëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht në përputhje me nivelet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në lidhje me nivelet e gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare për pranimet në programet e ciklit të tretë;</p> <p>-Të ketë dy rekomandime prej personelit me titull akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;</p> <p>-Të mos ketë aktualisht masa disiplinore ndaj tij në institucionet e arsimit të lartë, apo në institucionin e kërkimit bazë ose të zbatuar ku kandidati është i angazhuar;</p>



			<p>-Të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burtojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave mbi plagjiaturën;</p> <p>-Të vetëdeklarohet se është në gjendje të zbatohet standartet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor.</p> <p>Kritere specifike:</p> <p>- Të ketë përfunduar studimet e larta dhe të zotërojtë të paktën njërin nga diplomat “Master i Shkencave”, “Master i Arteve”, “Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë”, “Diplomë e Nivelit të Dytë”, “Diplomë Master Ekzekutiv”, “Diplomë lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatuar, së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës”, ose diplomë ekuivalente me to, në fushën e Ekonomisë/Turizmit ose në fusha të ngjashme dhe /ose të nderlidhura me fushën e Doktoratës në bazë të Akt-marrëveshjeve të lidhura të Departamentit të Turizmit, FEUNISHK.</p>
--	--	--	--

